



Home > Aktualitet > Konflikt me armë/ Parandalohet sherri në Elbasan, arrestohet autori i kanosjes ...

AKTUALITET

Konflikt me armë/ Parandalohet sherri në Elbasan, arrestohet autori i kanosjes dhe dy të tjerë (EMRI)

Nga policia është arrestuar S.LI 25-vjeç si poseduesi i armës i cili akuzohet për kanosje dhe E.Q 22-vjeç dhe F.B, 53 vjeç për moskallëzim të krimit.



Silvester Lleshi

21 Maj, 2019 8:47 Përditësuar: 8:55

Elbasan- 3 persona janë arrestuar në Bradashesh të Elbasanit pasi kanë kanosur me armë një person pasi një konflikti për motive të dobëta.

Nga policia është arrestuar Silvester Leshi LI 25-vjeç, i cili akuzohet për kanosje. Sipas policisë 25-vjeçari me një armë zjarri tip 'Zastava' kanosi personin me inicialet F.C. Ndërsa E.Q 22-vjeç dhe F.B, 53 vjeç akuzohen për moskallëzim të krimit.

Njoftimi i policisë:

Ndërhyrja në kohë e Policisë parandalon përshkallëzimin e mëtejshëm të një konflikti me pasoja të rënda për jetën.

Sekuestrohet një armë zjarri dhe fishekë luftarakë. Arrestohet në flagrancë poseduesi i armës. Në pranga dhe dy persona të tjerë të përfshirë në konflikt për motive të dobëta.

Policia e Elbasanit ka marrë njoftimin se në fshatin Bradashesh të Elbasanit po ndodh një konflikt ku njëri prej tyre ka dhe armë zjarri.

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, [Dosja.al](#)

Vlerësimi i situatës dhe reagimi në kohë i shërbimeve të policisë bëri të mundur parandalimin e përshkallëzimit të konfliktit, ku njëri prej shtetaseve të përfshirë në konflikt po kanoste me armë zjarri një shtetas tjetër.

Gjatë ndërhyrjes për parandalimin e konfliktit, Policia kapi në flagrancë me armë zjarri pistoletë shtetasin S.LI., 25 vjeç, banues në Elbasan, i cili gjatë një konflikti për motive të dobëta ka kanosur me armë zjarrit shtetasin F.C.

Në cilësinë e provës materiale është sekuestruar një armë zjarri tip Zastava me 5 fishekë.

Gjithashtu janë arrestuar edhe shtetasit E.Q, 22 vjeç, dhe F.B., 53 vjeç, të dy banues në Elbasan, për veprën penale moskallëzim i krimit.

Materialet iu kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për veprat penale të "Prodhimin dhe mbajtja pa leje e armëve luftarakë", "Kanosje" në ngarkim të shtetasit S.LI., si dhe për veprën penale "Moskallëzimi i krimi", në ngarkim të shtetaseve E.Q dhe F.B.

J.V/Dosja.al



ETIKETA: #arrestohen 3 persona në elbasan #arrestohet S.LI 25-vjeç #konflikti me armë në elbasan